

KRYEARTIKULL

BASHKË PËR BASHKI TË FORTA

Projekti STAR II

Eksperienca të mira të kryetarëve të bashkive të shqipërisë pas reformës administrative territoriale

VIJON NE FAQEN 8



EDITORIAL

Trinomi qeveri qendrore - qeveri lokale - komunitet

Anila Denaj
Ministre E
Financave Dhe
Ekonomisë



Bashkëpunimi i trinomit qeveri vendore-biznes-komunitet

është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e qyteteve tona dhe për krijimin e hapësirave miqësore, jo vetëm për fëmijët, por edhe grupe të tjera të komunitetit.

Në raport me kontributin e qeverisë, për pjesën e asaj shtylle që unë përfaqësoj, është e rëndësishme të theksojmë se çfarë ka bërë në këto vite qeveria shqiptare në disa aspekte. Në aspektin e parë do të përmendja decentralizimin e shumë roleve në vendimmarrje, duke i dhënë bashkive një rol më determinues në vendimmarrje për të përcaktuar politikat, për të përcaktuar dhe drejtimin e vendit lokal, së bashku me komunitetin e tij. Kuptohet që kjo është një punë që çdo kryetar bashkie e ndjek vetë më pas.

VIJON NE FAQEN 3

FORUMI LOKAL

Intervistë Majlinda Bufi

Të jesh pjesë e Delegacionit Shqiptar në Këshillin e Evropës është një eksperiencë sa e veçante, aq edhe e bukur. Ke mundësinë që në prani të vendeve me demokracinë më të zhvilluar ...

6



AKTIVITETE

Shkëmbim eksperiencash midis kryebashkiakëve shqiptarë dhe britanikë

Në muajin qershor 2018, Shoqata për Autonomi Vendore organizoi një vizitë studimore në Britaninë e Madhe, ku morën pjesë kryetarët e disa prej bashkive kryesore të vendit.

4



Përmbajtja

SHTATOR 2019 NUMRI 3



03. EDITORIAL

- Trinomi Qeveri Qëndrore - Qeveri Lokale - Komunitet

04. AKTIVITETE

- Shkëmbim eksperiencash midis kryebashkiakëve shqiptarë dhe britanikë
- Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës
- SHAV pjesë e STAR II, projektit për fuqizimin e bashkive
- Unioni i Bashkive Shqiptare
- Projekti FromME2EU

06. FORUMI LOKAL

- Intervistë me Nënkryetaren e Shoqatës për Autonominë Vendore, Majlinda Bufi
- Historiku rreth KE dhe Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës

08. HISTORI SUKSESI, PROJEKTI STAR II

- Bashkia Elbasan
- Bashkia Fier
- Bashkia Skrapar
- Bashkia Divjakë



**SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE**

Adresa

Bulevardi Zogu I,
Godina 7-katëshe, Kati 5

Email: alisa.jimaj@shav.al

EDITORIAL PËR AUTONOMI VENDORE

ZJ. ADELINA FARRICI - DREJTORESHË EKZEKUTIVE

Të dashur lexues,

Në emër të Shoqatës për Autonomi Vendore kam kënaqësinë t'ju drejtohem sërish përmes këtij numri të tretë të buletinit tonë periodik "Autonomia Vendore". Qëllimi kryesor i këtij buletini është informimi, edukimi dhe mundësimi i një dialogu të përherëshëm mes qytetarëve dhe të aktorëve të rëndësishëm në vend, rreth zhvillimeve më të fundit në sektorin e pushtetit vendor, e veçanërisht duke trajtuar tematika të ndryshme rreth autonomisë vendore dhe sfidave në qeverisjen lokale.

Në këtë numër të tretë lexuesi do të njihet me editoriale dhe zhvillime kryesore gjatë periudhës 2018 - 2019, siç janë bashkëpunimi qeveri qëndrore - lokale, vizita studimore të përfaqësuesve lokal dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar, Pjesëmarrja në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Këshillin e Europës, zbatimi i projektit STAR II për fuqizimin e bashkive si dhe histori suksesi si modele të mirëmenaxhimit në qeverisjen vendore.

Por çfarë tjetër është e rëndësishme janë dhe objektivat tona për vitin e ardhshëm. Së bashku, me kryetarët e rinj të bashkive dhe si Shoqata e vetme që do të përfaqësojë të 61 bashkitë e vendit, jam e lumtur të ndaj me ju sfidat dhe objektivat tona. Prioritetet tona për vitin që vjen do të jetë mbledhja e forumeve të shoqatës me fokus sugjerimin e çështjeve prioritare në fushat e Ekonomisë dhe Zhvillimit Vendor; Infrastrukturës dhe Urbanistikës; Çështjeve Sociale dhe Edukimit; Çështjeve Ligjore, Administrative dhe Prokurimeve; si dhe Financave Lokale dhe Tatim-Taksave & Tarifa.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i Shoqatës do të jetë rritja dhe fuqizimi i imazhimit kombëtar të SHAV përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm (stakeholderat: pushteti qëndror, universiteti, media, partnerët ndërkombëtar dhe ambasadat e huaja, shoqëria civile, opinion-bërësit, organizatat e biznesit, etj.) në funksion të politik-bërjes, rritjes së kapaciteteve dhe përcjelljes së



informacionit me qëllim hartim të planeve strategjike dhe aktivitete sipas grupeve specifike.

Promovimi dhe mbështetja në rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në administratën vendore do të jetë gjithashtu një aspekt i rëndësishëm në punën tonë të përditshme në funksion të përmirësimit të efikasitetit të administratës sikurse ngritja e njësieve për hulumtimin dhe komunikimin e politikave lokale që do të shërbejë si një "think-tank" për hartimin e manualeve dhe botimeve periodike për pushtetin vendor, tërheqjen e projekteve, mbledhjen e tryezave lokale, promovimin e bashkive dhe të modeleve të suksesit dhe përafrimin me standardet e pushtetit lokal evropian.

Së fundmi, rritja dhe konsolidimi i imazhit ndërkombëtar të Shoqatës përmes anëtarësimit të SHAV në organizmat ndërkombëtar të pushtetit lokal si e vetmja shoqatë që mbron interesat e të 61 bashkive të vendit do të jetë kurorëzimi i një pune të gjatë në funksion të bashkimit tonë me të drejta të plota në tryezat vendimmarrëse të organizmave të kontinentit ku janë dhe simotrat tona evropiane.

Duke ju falenderuar për kohën dhe konsideratën, lejomëni t'iu uroj kryetarëve të zgjedhur rishtazi një rrugëtim të mbarë në sprovën e tyre profesionale për të ndërtuar qytete që përfaqësojnë interesat e komunitetit të tyre urban dhe rural!

E juaja, Adelina Farrici

TRINOMI QEVERI QËNDRORE - QEVERI LOKALE - KOMUNITET

ANILA DENAJ-MINISTRE E FINANCAVE DHE EKONOMISË

VIJON NGA FASE 1

Dua të marr shkas nga një konferencë e organizuar në bashkëpunim me USAID, i cili ka qenë një partner shumë i rëndësishëm për ne në gjithë këtë proces, ku për herë të parë u prezantua raporti zyrtar për financat vendore. Ishte një raport që tregonte se si ky proces decentralizimi, në këto hapa të para, mund të ndihmojë për të projektuar më mirë në hapat e dyta e më tej, si në aspekt të të ardhurave të gjeneruara nga bashkitë, ashtu edhe në raport me shpenzimet dhe ku këto shpenzime janë të fokusuar.

Krahas shpenzimeve administrative, ato kapitale, dhe operative, ftesa që do të bëjë është që pas një kohe të caktuar të kishim kritere të tjera, përveç këtyre zërave, se si do t'i lexonim këto shpenzime, në atë atë që do të jenë shpenzime për ta bërë qytetin më miqësor ndaj fëmijëve, ndaj individëve me aftësi të kufizuara, apo të qytetarëve më të marginalizuar, e të tjera objektiva që duhet të ketë bashkia respektive dhe Këshillat Bashkiak.

Është e rëndësishme që në këtë projekt decentralizimi të vendosim objektiva dhe të masim performancën. Kuptohet që bashkërendimi qeveri qendrore dhe lokale është i përhershëm, mbështetet në parimet objektive të planifikimit, por vendosja e performancës dhe treguesve është po aq e rëndësishme. Kemi nevojë të mësojmë dhe brendësojmë të gjithë ato kritere të cilat do të na ndihonin ne për ta bërë qytetin më miqësor, e para për ta ndërtuar atë, bashkë me komunitetin, dhe pastaj për të matur nëse jemi duke bërë gjënë e duhur në kohën e duhur.

Kuptohet që ka një shtyllë të rëndësishme, shtylla komunitet, dhe unë do të ftoja që bizneset të shikonin pak më hapur këtë qasje sot, të mendonin edhe ata përveç qeverisë qendrore apo asaj lokale se çfarë mund të bëjnë për t'i bërë ambientet e tyre të shërbimit më të hapura ndaj pranimit të fëmijëve apo rritjes së kënaqësisë së konsumatorit, nëse fëmijët do t'i



Bashkëpunimi i trinomit qeveri vendore - biznes - komunitet është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e qyteteve tona dhe për krijimin e hapësirave miqësore, jo vetëm për fëmijët, por edhe grupe të tjera të komunitetit.

konsideronim si konsumatorë, sepse nuk lidhet vetëm me kënaqësinë, por lidhet dhe me biznesin e tyre, kështu që është një ftesë dhe për ata, për një kuptueshmëri më të lartë për të gjithë palët në këto marrëdhënie, për ta çuar përpara komunitetin.

Është e rëndësishme që të marr si shembull nevojën për të krijuar një bazë më të mirë dhe strehimin si një shembull edhe të objektivit që ka qeveria shqiptare për të ndihmuar në disa aspekte të tjera në nivel qendror. Në vitin 2018 është rritur me gati 30 për qind pjesa e buxhetit e adresuar në strehim ky është një tregues i angazhimit që ka kjo qeveria për të çuar përpara reformat në të gjitha aspektet, por dhe në mbështetje e ndihmë sociale.

Nuk dua të lë pa përmendur dhe ligjin më të fundit, atë të nxitjes së Punësimit, i cili i jep një fokus shumë të rëndësishëm nxitjes në punësim të atyre kategorive të cilat sot mund të jenë pak më të nënvlerësuara, me aftësi të kufizuara, por që janë të aftë për të hyrë në tregun e punës dhe mund të rezultojnë po aq produktivë sa të gjithë ne.

Kemi nevojë të zhvillojmë debatin tonë të frytshëm, të shkëmbejmë sa më shumë informacion se si ne të ndërtojmë më tej objektivat tanë, si të përcaktojmë disa kritere, qoftë dhe matje të performancës më vonë, dhe mbi të gjitha të realizojmë që trinomi qeveri qendrore-qeveri vendore-komunitet të funksionojë së bashku në një dialog permanent për të vazhduar më tej objektivin.

Arritje

AKTIVITETE

Shoqata për Autonominë Vendore ka zhvilluar një numër aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2018 - 2019.

SHKËMBIM EKSPERIENCASH MIDIS KRYEBASHKIAKËVE SHQIPTARË DHE BRITANIKË

Në muajin qershor 2018, Shoqata për Autonomi Vendore organizoi një vizitë studimore në Britaninë e Madhe, ku morën pjesë kryetarët e disa prej bashkive kryesore të vendit. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me modelin më të mira të politikëbërjes dhe administrimit në nivel lokal nga autoritetet e qeverisjes vendore britanike, nxitja

e bashkëpunimeve ekonomike përmes projekteve të përbashkëta dhe tërheqjes së investimeve angleze në Shqipëri.

Bashkia e Brentit ishte ndalesa kryesore, ku anëtarët e delegacionit u njohën dhe shkëmbyen informacione mbi çështje të rëndësishme për komunitetin, siç janë strehimi dhe banesat sociale, mjedisi, transporti publik dhe rekreacioni. Një vëmendje e veçantë gjatë këtij takimi u kushtua integritetit të komunitetit shqiptar në këtë



AUTONOMIA VENDORE

Përmes forcimit të autonomisë vendore synohet më shumë të drejta dhe liri për qytetarët brenda një njësie të caktuar vendore. Në këtë aspekt, më shumë mundësi për vetëqeverisje përmes strukturave dhe mekanizmave demokratik të zgjedhur prej tyre, do të thotë më shumë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

DECENTRALIZIMI

Transferimi i më shumë pushteti nga qeverisja qendrore drejt bashkive të vendit sjell një zvogëlim domethënës në kohën e marrë për vendimmarrjen, reduktimin e kostove administrative dhe plotësimin e nevojave reale të komunitetit.

DEMOKRACIA LOKALE

Gjithëpërfshirja e qytetarëve, sektorit privat dhe organizatave jo qeveritare të komunitetit në proceset vendimmarrëse lokale dhe zotërimi në duart e tyre të mekanizmave të llogaridhënies është një parakusht për një demokraci lokale funksionale.

Sferat

Kryesore

lokalitet. Në vijim, kryetarët diskutuan mbi mundësinë e bashkëpunimit mes bashkive të tyre dhe asaj të Brentit, në nivel projektesh dhe asistence teknike.

Gjatë vizitës, delegacioni i SHAV u prit nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Sh.T.Z. Qirjako Qirko, i cili theksoi përpara kryetarëve faktin se Anglia është një vend model në drejtim të mirëmenaxhimit të pushtetit vendor askpektit social.

Një moment i veçantë ishte vizita në Parlamentin Britanik (Westminster), ku delegacioni u prit nga anëtari i Parlamentit, z. John Grogan, i cili është njëkohësisht dhe kryetari i grupit të miqësisë Shqipëri-Angli. Fokusi i këtij takimi u përqëndrua mbi potencialet e bashkëpunimit midis dy vendeve.

SHAV MERR PJESË NË SESIONIN E 35-TË DHE TË 36-TË TË KONGRESIT TË AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE TË KESHILLIT TE EUROPËS

NENTOR 2018 DHE PRILL 2019

Në nëntor 2018, SHAV mori pjesë në Kongresin e 35-të të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Europës. Kongresi përfaqëson një forum ku përfaqësuesit lokalë dhe ata të zgjedhur rajonalë të shteteve anëtare mund të diskutojnë problemet e tyre të përbashkëta, ndajnë eksperiencën e tyre dhe të shprehin pikëpamjet e qeverive të tyre.

Një ndër funksionet e Kongresit është të ndihmojë shtetet e reja anëtare me aspektet praktike të progresit të tyre drejt krijimit të vetë-qeverisjes efektive lokale e rajonale.

SHAV u përfaqësua në Kongres nga nënkryetarja e shoqatës, znj. Majlinda Bufi, Sotiraq Filo dhe Sajmir Plaku. 'Integriteti dhe sjellja etike nga ana e përfaqësuesve të



zgjedhur lokalë dhe rajonalë' ishte tematika e radhës e Kongresit, i cili mbledhet 2 herë në vit. Në këto sesione të Kongresit Shoqata ndau disa prej eksperiencave nga pushteti lokal të disa bashkive të suksesshme të vendit.



RRITJA E KAPACITETEVE

Zhvillimi i kapaciteteve në qeverisjen vendore dhe fuqizimi i administratës lokale është një prej përpjekjeve kryesore në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor. Prioriteti i SHAV është mbështetja e administratës lokale, për t'iu përgjigjur pritshmërive dhe nevojave të komunitetit për shërbime publike të specializuara.



EDUKIMI DHE SPORTI

Edukimi dhe sporti janë dy komponent tejet të rëndësishëm për zhvillimin e një ekosistemi social-kulturor të qëndrueshëm për çdo komunitet në vend. SHAV ka si mision që përmes nxitjes së bashkëpunimit shkollë-komunitet-familje në proceset promovuese dhe zhvilluese të formimit personal të të rinjve në njësinë vendore të përfshijë ata vetë në vendimmarrjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre personale.



MJEDISI

Bashkëpunim mes të gjithë aktorëve të njësisë vendore për mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit të lokalitetit është një domosdoshmëri për ruajtjen dhe zhvillimin e ambientit ku këto komunitete punojnë dhe jetojnë.





Unioni i Bashkive Shqiptare ka për qëllim të krijojë klimën dhe mekanizmat e duhura të bashkëpunimit mes qyteteve shqiptare në rajon, ndërkohë që u krijon mundësi bashkive të rrisin shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në fushat e urbanistikës, inovacionit, mjedisit, kulturës dhe formave të reja të financimit.

MBLIDHET PËR HERË TË 3-TË NË TETOVË UNIONI I BASHKIVE

Kryetarët e bashkive Tiranë, Prishtinë, Tetovë, Vlorë, Prizren, Ulqin, Preshevë dhe Gostivarë nënshkruan në muajin tetor në Tetovë Statutin e organizatës "Unioni i Bashkive Shqiptare".

Unioni i Bashkive Shqiptare ka për qëllim të krijojë klimën dhe mekanizmat e duhura të bashkëpunimit mes qyteteve shqiptare në rajon, ndërkohë që u krijon mundësi bashkive të rrisin shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në fushat e urbanistikës, inovacionit, mjedisit, kulturës dhe formave të reja të financimit.

Në bazë të marrëveshjes së firmosur takimin e parë të zhvilluar në Tiranë, bashkitë angazhohen për të bashkëpunuar për tërheqjen e fondeve dhe të projekteve rajonale dhe ndërkufitare, ndonjëherë dhe duke aplikuar bashkë, aty ku mund të aplikohet, si dhe mbështetja e njëri-tjetrit me masa, asete, ekspertizë, dhe personel në rast të emergjencave civile.

SHAV PJESË E STAR II, PROJEKTIT PËR FUQIZIMIN E BASHKIVE

Shoqata për Autonomi Vendore ka nisur bashkëpunimin për zbatimin e projektit për ofrimin e asistencës për "Fuqizimin e Kryetarëve të Bashkive nëpërmjet programit të shkëmbimit të eksperiencës mes njëri-tjetrit", në kuadër të projektit STAR2: Konsolidimi i Reformës Administrative Territoriale, zbatuar në Shqipëri nga PNUD dhe mbështetur nga BE, Qeveria e Italisë, Suedisë, Zvicrës, USAID, UNDP dhe Qeveria e Shqipërisë.

Ky projekt synon mbështetjen e 61 Kryetarëve të Bashkive të Shqipërisë përmes programit të shkëmbimit të eksperiencës, me synim forcimin e aftësive drejtuese dhe administrative të njësisive të qeverisjes vendore.

Në këtë kuadër, Shoqata do të zhvillojë një sërë aktiviteteve, si identifikimi i arritjeve dhe sfidave të Kryetarëve të Bashkive, botimi i një broshure dhe



transmetimi i një dokumentari me eksperiencat më të mira vendore, organizimi i tryezave të rrumbullakta rajonale, si dhe organizimi i një konference kombëtare për ndarjen e eksperiencave më të mira dhe prezantimin e arritjeve në nivel vendor.

PROJEKTI FROMME2EU

Projekti FromME2EU i zbatuar nga Shoqata Per Autonomi Vendore dhe UET Centre ka për synim të krijojë mundësi për qytetarët europianë dhe komunitetet e migrantëve për të punuar së bashku, duke promovuar idenë e një Europe multikulturale.



“Forumi Lokal” është rubrika e cila do të trajtojë analiza, komente, intervista dhe opinione ardhur drejtpërdrejt nga drejtues dhe punonjës të njësive administrative nga i gjithë vendi. Kjo rubrikë synon të mbulojë një sërë tematikash me rëndësi për jetën dhe aktualitetin në komunitetet lokale në mbarë Shqipërinë. Në numrin e parë, përmes një interviste të shkurtër me katër personazhe nga bashki të ndryshme të vendit, vijnë për lexuesin katër tema që lidhen drejtpërdrejt me procesin e reformës territoriale dhe të decentralizimit.

1



CILA ËSHTË EKSPERIENCA JUAJ SI ANETARE E DELAGACIONIT SHQIPËTAR NË KONGRESIN E AUTORITETEVE LOKALE DHE RAJONALE NË KËSHILLIN E EUROPËS?

MAJLINDA BUFI- NËNKRYETARE E SHOQATËS PËR AUTONOMI VENDORE

Të jesh pjesë e Delegacionit Shqiptar në Këshillin e Europës është një eksperiencë sa e veçante, aq edhe e bukur. Ke mundësinë që në prani të vendeve me demokracinë më të zhvilluar, në praninë edhe të vendeve që janë në zhvillim, të mund të tregosh pjesën më të mirë e më të bukur të vendit tënd, të tregosh se rruga për të arritur aty ku të tjeret sot mburren me atë që janë, nuk është e lehtë. Por ti je nga ai vend që e ka këtë vullnet, dhe ky vend është Shqipëria.

Perveç faktit që ke mundësinë të marrësh dhe të japësh eksperiencë, të mësosh nga modelet më të mira të qeverisjes vendore, përmes projekteve të ndryshme mund edhe të kthehesh në një model për vendet e tjera në zhvillim dhe me demokraci më të re se në Shqipëri. Mund të përmend rastin e Armenisë, ku isha e ftuar me një prezantim konkret për rolin e grave në zgjedhjet vendore.



Përmes misionëve të ndryshme, ke mundësinë të shohësh dhe të jesh pjesë në grupe vëzhgimi dhe monitorimi në procese zgjedhore. Për mua, ishte vërtet mbresëlënëse pjesëmarrja në zgjedhjet vendore në Finlandë. Sa e rëndësishme ishte për qytetarët pjesëmarrja në këto zgjedhje, ku secili prej tyre mund të bëhej pjesë e listës së kandidatëve vetëm përmes një kërkesë të thjeshtë të dorëzuar në KQZ. Procesi i votimit, komisionet e votimit jo politike (qytetarë të profesioneve të ndryshme) dhe rezultati që dilte në kohë reale me numërimin e votave nga ky komision ishin aspekte të tjera për t'u vlerësuar.

Të gjitha këto e të tjera janë eksperiencë që t'i jep vetëm ky mision.



FORUMI LOKAL

Rreth Këshillit të Europës dhe Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Europës

Këshilli i Europës, themeluar në vitin 1949, është organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinent. Pjesë e tij janë 47 shtete europiane, 28 prej të cilave janë pjesë e Bashkimit Europian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit kanë nënshkruar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat që synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit në Europë. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut është organi që mbikqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Europës përfaqëson një forum ku përfaqësuesit lokalë dhe ata të zgjedhur rajonalë të shteteve anëtare mund të diskutojnë problemet e tyre të përbashkëta, ndajnë eksperiencën e tyre dhe të shprehin pikëpamjet e qeverive të tyre. Një ndër funksionet e Kongresit është të ndihmojë shtetet e reja anëtare me aspektet praktike të progresit të tyre drejt krijimit të vetë-qeverisjes efektive lokale e rajonale.

Kongresi u krijua në vitin 1994 nga Këshilli i Europës dhe synon të jetë zëri i rajoneve dhe bashkive në Këshillin e Europës. Në përbërje të kongresit ka tri komitete: Monitorimi, Qeverisja dhe Çështjet Korente. Kongresi mbledhet dy herë në vit, në pranverë dhe në vjeshtë të çdo viti, për të diskutuar çështje tematike.



HISTORI SUKSESI PROJEKTI STAR II

SHTATOR 2015 - SHTATOR 2018

EKSPERIENCA TË MIRA TË KRYETARËVE TË BASHKIVE TË SHQIPËRISË PAS REFORMËS ADMINISTRATIVE TERRITORIALE

BASHKIA ELBASAN

•RRITJA E SIGURISË PUBLIKE NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Prej kohësh, institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Elbasan ishin ndeshur me problematika të ndryshme, të cilat çënonin shëndetin dhe mirëqënien e nxënësve të këtyre institucioneve, si dhe realizimin me sukses të orës së mësimit. Menaxhimi jo efektiv i orës së mësimit, bulizmi, dhuna fizike dhe psikologjike, përdorimi i drogës dhe alkoolit, ishin disa prej çështjeve të cilat sollën nevojën për monitorimin e këtyre institucioneve.

Duke marrë shkas nga sugjerimet dhe komentet e banorëve gjatë dëgjësave qytetare dhe mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, kryetari i Bashkisë Elbasan



ndërmori një nismë, me qëllim rritjen e sigurisë publike në sistemin arsimor parauniversitar, përmes:

- Instalimit të kamerave të sigurisë në të gjitha institucionet e arsimit para universitar;
- Përfshirjes së policisë bashkiake për ruajtjen e sigurisë në institucionet arsimore;
- Ngritjes së një stafi të posaçëm për ruajtjen e qetësisë dhe rendit në institucionet arsimore ku kamerat mungojnë;
- Rritjes së shërbimeve për ruajtjen e sigurisë në institucionet parauniversitare.

Kjo nismë u vu si prioritet nga Bashkia dhe u zbatua në saj të buxhetit të saj. Falë kësaj zbatimit të kësaj nisme kanë përfituar 105.000 fëmijë dhe nxënës, nga të cilët 4.000 përfitues nga komuniteti Rom, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e nënave me urdhër mbrojtjeje, etj. Gjithashtu, kjo nismë nxiti rritjen e shkallës së bashkëveprimit midis institucioneve përgjegjëse për ofrimin e sigurisë publike. Bashkia Elbasan, si pjesë të strategjisë së saj, synon të vazhdojë punën për rritjen e bashkëpunimit komunitet-prind-nxënës-institucion-mësues apo grupe vullnetare që ofrojnë shërbime për arsimin parauniversitar.

BASHKIA FIER

• REHABILITIMI I KANLEVE KULLUESE DHE VADITËSE

Gjendja e sistemit të kanaleve kulluese në Bashkinë Fier ishte shumë e rëndë dhe shqetësuese. Prej afro 30 vitesh nuk kishte patur investime në rehabilitimin e kanaleve kulluese dhe procesi i vaditjes ka qënë i pakontrollueshëm. Ujrat e kodrave përreth të mblihdeshin në këtë kanal dhe shkaktonin përmbytjen e tokave të punueshme, duke sjellë pasoja të rënda në bujqësinë dhe ekonominë e zonës dhe duke shkaktuar pakënaqësi të qytetarët, të cilët vazhdimisht ngrinin ankesa.

Falë praktikës së mirë të dëgjësave qytetare dhe diskutimit të mëtejshëm të tematikave në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, çështja e sistemit të kullimit gjeti zgjidhjen e shumëpritur. Me kërkesën e lidërshipt të



Bashkisë, u ndërmor një nismë për rehabilitimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse, e cila konsistonte në:

- Investimin në rehabilitimin e kanaleve kulluese e vaditëse ekzistuese;
- Përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje nëpërmjet organizimit të dëgjesave qytetare dhe përfshirja e sugjerimeve të tyre në planin e punës;
- Ristrukturimin e burimeve njerëzore të bashkisë nëpërmjet ngritjes së Drejtorisë së Kullimit dhe Vaditjes dhe rekrutimit të ekspertëve për zbatimin sa më të mirë të ndërhyrjes;
- Përmirësimin e tokave bujqësore.

Nisma u planifikua dhe u zbatua falë buxhetit të Bashkisë Fier dhe mbështetjes nga qeveria qendrore nëpërmjet transfertave të kushtëzuara. Investimi kishte për qëllim zhvillimin e zonave rurale dhe sektorit të bujqësisë, duke shmangur përmytjet dhe përmirësimin e këtyre tokave, pasi cilësia e ulët e pjellorisë së tyre cënonte prodhimin bujqësor, ndaj dhe rehabilitimi i këtij kanali kullues ka marrë një rëndësi të veçantë.



Falë ndërhyrjes, u arrit rehabilitimi i kanaleve kulluese e vaditëse në pothuajse të gjithë territorin e Bashkisë Fier. Kjo është një lehtësi për banorët dhe sipërmarrjet bujqësore të zonës, pasi garanton shmangien e përmytjeve që shkaktohen nga dalja e Lumit Vjosë dhe reshjet e shumta në më shumë se 70 ha tokë bujqësore. Përmes nismës, u pastruan 495,6 km kanale

kulluese e vaditëse, u hapën kanale të reja primare, si dhe 335.108 metër linear kanale të dyta dhe të treta, u hapën rrugë të parcelave. 31.622 ha tokë bujqësore u përmirësuan si rezultat i zbatimit të nismës, duke sjellë në tërësi përfitim për 90.000 banorë.

Bashkia Fier synon shtimin e mjeteve në dispozicion me qëllim ndërhyrjen për rehabilitimin e kanaleve kulluese e vaditëse në të gjitha Njësitë Administrative në të njëjtën kohë.

BASHKIA SKRAPAR

• REALIZIMI I QENDRËS DITORE TË SPECIALIZUAR PËR FËMIJËT ME NEVOJA NDRYSHE

Bashkia Skrapar i ka kushtuar vëmendje rritjes së shërbimeve të aksesueshme për fëmijët me nevoja ndryshe (veçanërisht për ata të prekur nga spektra të ndryshëm të autizmit) dhe gjithëpërfshirjen e tyre në jetën sociale dhe kulturore. Gjatë dëgjesave publike dhe konsultimeve të Bashkisë me qytetarët, u identifikua nevoja për ngritjen e një qendre ditore, e cila do të ofronte një sërë shërbimesh për këtë grup vulnerabël.

Me mbështetjen e shoqatës zvicerane ASSED, bashkia zbatoi një nismë që synonte përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre fëmijëve, e cila konsistonte në:

- krijimin e një Qendre ditore të specializuar për fëmijët me nevoja ndryshe;
- sensibilizimin e popullsisë në zonat urbane dhe rurale lidhur me nevojat dhe trajtimin e duhur të këtyre fëmijëve;
- zhvillimin e takimeve informuese në qytet, me prindërit e fëmijëve me nevoja ndryshe, me qëllim sigurimin e një mbështetje të koordinuar në familje dhe në qendër.

Ndër shërbime të tjera, kjo qendër, e cila prej dy vitesh operon me fondet e Bashkisë, ofron terapi për zhvillimin motorik dhe psikologjik të fëmijëve me aftësi ndryshe, si dhe transport në shtëpi pas shërbimit terapeutik. Kjo qendër ofron pa pagesë një gamë shërbimesh në ndihmë të fëmijëve me




nveoja ndryshe dhe familjarëve të tyre, duke nisur nga vlerësimet psikologjike e deri në këshillimin e prindërve.

Shërbimet ofrohen për fëmijët me çrregullime të komunikimit dhe sjelljes, ata të prekur nga Sindroma Down, autizmi, etj. Misioni i qendrës është integrimi i këtij grupi vulnerabël në jetën sociale. Ndër të tjera, kjo qendër, e cila prej dy vitesh operon me fondet e Bashkisë, ofron terapi për zhvillimin motorik dhe psikologjik të fëmijëve me aftësi ndryshe, si dhe transport në shtëpi pas shërbimit terapeutik.



Bashkia Skrapar synon zbatimin e kësaj nisme edhe në njësitë e tjera administrative, me qëllim ofrimin e shërbimit sa më pranë qytetarëve. Rritja e kapaciteteve dhe specializimi i ekspertëve që ofrojnë këto shërbime, si dhe vendosja e kamerave të sigurisë për monitorimin e fëmijëve në qendra janë disa nga planet për të ardhmen.

Zbatimi i kësaj nisme vjen gjithashtu në kuadër të zbatimit të ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", i cili përfaqëson mbrojtje të veçantë për fëmijët me aftësi ndryshe, si dhe garantim të të gjitha të drejtave.



URA VAJGUORE

Mangësitë në shërbimet administrative në bashkinë e Urës Vajguore shoqëroheshin me disa problematika në infrastrukturën e shërbimeve, vështirësimin e plani kimit të realizimit të proceseve dhe mungesën e transparencës në vendimmarrje.

Ndaj nga lidershipi i Bashkisë duke vlerësuar sugjerimet e banorëve gjatë dëgjësave me ata dhe mbledhjet me Keshillin Bashkiak, u morr iniciativa për ngritjen e një sistemi të integruar ku qytetarët mund të për tonin një tërësi shërbimesh.

Elementet kryesorë të ndërhyrjes përfshijnë:

- Krijimin e një platforme dixhitale për rritjen e informacionit për qytetarët;
- Riorganizimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Shërbimin administrativ në kohë sa më të shkurtër dhe ofrimin e shërbimeve nëpërmjet telefonit - e - Bashkia;
- Zhvillimin e takimeve informuese me qytetarët e Bashkisë;
- Organizimin e fushatave informuese dhe promovuese mbi ndërhyrjen, në mediat lokale dhe faqen e Bashkisë.

Ndryshimi nëpërmjet treguesve të suksesit:

- Shkurtimi i kohës së kryerjes së shërbimeve administrative dhe standartizimin i shërbimit për zonat urbane dhe rurale;
- Informimi në kohë reale/rritje transparence ndaj qytetarëve;
- Minimizim gabimesh, rritje e integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit;
- Eleminimi i veprimeve manuale dhe automatizimi i proceseve të punës;
- Plotësimi i kërkesë - ankesave në çdo moment pa qenë e nevojshme paraqitja në Bashki;
- Integrimi i pagimit të taksave;



- Gjenerimi i vërtetimeve nga sistemi, nuk lejon abuzime, dixhitalizimi në këtë rast bën të mundur trajtimin e të gjithë banorëve në mënyrë të barabartë dhe parandalon korrupsionin;
- 39.870 banorëve, një pjesë e mirë nga grupe të margjinalizuara u janë lehtësuar dhe shkurtuar procedurat për për timin e shërbimeve.

Bashkia, synon zbatimin e këtij projekti dhe në njësitë e tjera administrative me qëllim ofrimin e shërbimit sa më pranë qytetarëve. Rritja dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit mbi ndryshimet ligjore, harmonizimi dhe koordinimi i mëtejshëm i zyrave pritëse me ato përgjegjëse si dhe informimi i mëtejshëm i qytetarëve rreth këtij shërbimi janë disa nga objektivat e ardhshëm.

BASHKIA DIVJAKË

• ZHVILLIMI I UNAZËS BUJQËSORE

Bashkia Divjakë përfaqëson një ndër zonat e Shqipërisë me zhvillim të lartë të bujqësisë. Një ndër problematikat më të mëdha me të cilën janë përballur banorët e zonës ishte vështirësia në komunikimin ndërmjet parcelave bujqësore dhe fshatrave, si dhe transporti i produkteve bujqësore drejt zonave urbane me qëllim tregtimin. Deri vonë, mungonte infrastruktura e nevojshme për të përmbushur këto funksione.

Si përgjigje ndaj nevojave të qytetarëve, të shprehura gjatë dëgjësave publike, Kryetari i Bashkisë ndërmori një nismë për rindërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës rrugore, për të lehtësuar aksesin e tregjeve të shitjes së produkteve bujqësore. Ndërtimi unazës bujqësore në zonën e Divjakës ka lehtësuar jo vetëm qarkullimin e mjeteve dhe qytetarëve drejt njësitë të kësaj Bashkie, por i ka dhënë qytetit një

zhvillim të dukshëm ekonomik, përmes krijimit të lehtësirave për eksportin e produkteve vendase. 25.000 qytetarë, nga të cilët 5.000 persona të komunitetit rom dhe egjiptian, kanë përfituar nga ky investim, i zbatuar me financimin e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Lehtësimi i qarkullimit i mjeteve dhe zhvillimi urban i qytetit, zhvillimi i bujqësisë përmes investimeve në infrastrukturën rrugore dhe lidhjes së qendrës urbane me zonat rurale, si dhe rritja e të ardhurave të Bashkisë përmes investimeve në infrastrukturë janë disa përfitime të tjera të dukshme nga zbatimi i nismës.

Sot në Divjakë shihet qartë ndryshimi i ndodhur, ku mundësitë për tregti janë përmirësuar ndjeshëm. Për të ardhmen, Bashkia Divjakë planifikon mirëmbajtjen e investimeve ekzistuese dhe shtimin e investimeve në njësi të tjera.



ANËTARËT



Bashkia Belsh



Bashkia Berat



Bashkia Bulqizë



Bashkia Cerrik



Bashkia Delvine



Bashkia Divjakë



Bashkia Durrës



Bashkia Elbasan



Bashkia Fier



Bashkia Finiq



Bashkia Fushë Arrëz



Bashkia Gjirokastrë



Bashkia Gramsh



Bashkia Has



Bashkia Himarë



Bashkia Kavajë



Bashkia Këlcyrë



Bashkia Kolonjë



Bashkia Konispol



Bashkia Korçë



Bashkia Krujë



Bashkia Kuçovë



Bashkia Kurbin



Bashkia Libohovë



Bashkia Librazhd



Bashkia Lushnjë



Bashkia Malësi Madhe



Bashkia Maliq



Bashkia Memaliaj



Bashkia Mirditë



Bashkia Patos



Bashkia Peqin



Bashkia Peshkopi



Bashkia Polican



Bashkia Prrenjas



Bashkia Pukë



Bashkia Pustec



Bashkia Roskovec



Bashkia Rogozhinë



Bashkia Sarandë



Bashkia Shijak



Bashkia Skrapar



Bashkia Tepelenë



Bashkia Tiranë



Bashkia Ura Vajgurore



Bashkia Vlorë

PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statutë, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfitim e eksperiencave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrejetet më të rëndësishme të shoqatave lokale Europiane dhe JugLindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



UNITED NATIONS



UNDP



EU COMMISSION




EU DELEGATION



USAID



US EMBASSY IN TIRANA



SWISS COOPERATION



GIZ



HANS SEIDEL FOUNDATION



FRIEDRICH EBERT STIFTUNG FOUNDATION



OPEN SOCIETY FOUNDATION



OSCE



GOVERNMENT OF ALBANIA



PARLIAMENT OF ALBANIA



NALAS



CCER

EUROPEAN ASSOCIATION
OF LOCAL DEMOCRACYEMILIA ROMAGNA
anci

CNVP

AUSTRIAN DEVELOPMENT
COOPERATION

FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE



KDZ



WORLD VISION

FEDERATA KOMBËTARE E PYJEVE
DHE KULLOTAVE KOMUNALE

VNG INTERNATIONAL

DECENTRALIZATION AND LOCAL
DEVELOPMENT PROGRAMME

THE WORLD BANK

Website i ri I pasuruar me përmbajtje substanciale dhe rubrika të reja novatore

Na vizitoni në www.shav.al



Të rejat më të fundit dhe nga celulari juaj?

Për t'u informuar në kohë reale

REGJISTROHU



**SHOQATA
PËR AUTOMINË
VENDORE**

